## Titulli i lëndës: Projektimi i ndërtesave pasive diellore

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| Njësia akademike: | **Fakulteti i Arkitekturës** |
| Titulli i lëndës: | **Projektimi i Ndërtesave Pasive Diellore** |
| Niveli: | **Master Shkencor  Efiçienca e Energjisë** |
| Statusi i lëndës: | **Obligative** |
| Viti i studimeve: | **Viti i dytë / Semestri i parë** |
| Numri i orëve në javë: | **2+2** |
| Kreditë ECTS: | **6** |
| Koha / Vendi: | **Sipas orarit / sipas orarit** |
| Mësimdhënësi: | **Prof. Ass. Dr. Miranda Rashani** |
| Të dhënat kontaktuese: | **e-mail: miranda.rashani@uni-pr.edu** |
| | |
| Përshkrimi i lëndës: | Rritja e ndërgjegjësimit për sfidat e ndryshimeve klimatike globale, mungesa e burimeve të energjisë dhe dëmtimi mjedisor e bëjnë të nevojshme projektimin dhe ndërtimin e ndërtesave të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Ndërtesat pasive diellore janë një parakusht dhe qasje fillestare për performancë të lartë të energjisë dhe ndërtesave të qëndrueshme.<br>Kjo lëndë shqyrton themelet dhe parimet e arkitekturës diellore pasive dhe ndërtimit të qëndrueshëm. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i kësaj lënde është të ndihmojë studentët të zhvillojnë dijeni më të mirë të praktikës së arkitekturës pasive diellore, ndërtimit të qëndrueshëm, ekonomisë ekologjike dhe qasjeve që mund të përdoren për të menaxhuar burimet në mënyrë më të qëndrueshme duke përmirësuar cilësinë e jetës për njerëzit. Lënda synon të përgatisë, angazhojë dhe sfidojë studentët për të kuptuar dhe thelluar më tej njohuritë e tyre për projektimin dhe ndërtimin e ndërtesave pasive diellore. |
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | Nëpërmjet të kuptuarit dhe interpretimit të zhvillimeve në arkitekturë që lidhen me parimet e arkitekturës pasive diellore, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë, analizojnë, interpretojnë dhe dizajnojnë ndërtesat pasive diellore. |
| **Rëndësia dhe aktualiteti i lëndës** | Dizajni i ndërtesës pasive diellore kontribuon në uljen e konsumit të përgjithshëm të energjisë dhe, për rrjedhojë, në rritjen e cilësisë së aspekteve socio-ekonomike dhe mjedisore. |

| Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit) | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë mësimore** | **Ditë/Javë** | **Gjithsej** |
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | - | - | - |
| Përgatitje për test intermediar | 4 | 4 | 16 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 1 | 8 | 8 |
| Puna në terren | 2 | 1 | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Testi, punimi seminarik | 2 | 2 | 4 |
| Detyrë shtëpie | 4 | 4 | 16 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 8 | 16 |
| Përgatitja për provimin final | 4 | 4 | 16 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 4 | 2 | 8 |
| Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë... | | | **150** |
| **Total** | | | |

**Metodat e mësimdhënies:**

Mësimdhënia ofrohet përmes ligjeratave dhe aktiviteteve ndërveprurese, me theks të veçantë mbi diskutimet dhe shembujt praktikë. Përveç ligjeratave, ofrohen edhe seminare dhe detyra numerike, vizita në terren dhe punë ekipore.

**Metodat e vlerësimit:**

Kufiri kalueshmërisë së lëndës 55%.

Aktiviteti i studentëve 10%;

Detyrat individuale/grupore 40%;

Dy teste të ndërmjetme 50% apo Provimi Final 50%.

Sistemi i vlerësimit:

| Përqindja | 10 | 9 | 8 | 7 | 6 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 50% Cilësi | | | | | | |
| 20% Origjinalitet | | | | | | |
| 10% Sasi | | | | | | |
| 20% Gramatikë/ grafikë | | | | | | |

95 -100%=10

85 - 94% = 9

75 - 84% = 8

65 - 74% = 7

55 - 64% = 6

00 - 54% = 5 nuk kalon (përsëritë lëndën)

***Studenti përsëritë lëndën nëse:***

- Pjesëmarrja/aktiviteti i kërkuar nuk arrihet (lejohen deri në 3 mungesa)
- Nuk arrihet pragu i vlerësimit prej 55%

| | |
|---|---|
| **Literatura primare:** | [1] Miranda Rashani: Prezantimet e ligjeratave që do të shpërndahen tek studentët pas çdo njësie të zhvilluar<br>[2] Steven V. Szokolay: Introduction to Architectural Science: The Basis of Sustainable Design (partially translated by Dr. Sc. Miranda Rashani)<br>[3] Tom Woolley, Sam Kimmins: Green Building Handbook (volume 1 and 2)<br>[4] Michael Bauer, Peter Mösle, Michael Schwarz. Green Building – Guidebook for Sustainable Architecture (2007) |
| **Literatura shtesë:** | [5] . E. Michaelides: Energy, the Environment, and Sustainability, CRC Press, 2018<br>[6] https://www.designingbuildings.co.uk/<br>[7] https://www.phius.org/ |

| Java | Titulli i ligjëratës |
|---|---|
| ***Java 1:*** | **Hyrje në dizajnin pasiv, parimet dhe strategjitë** |
| ***Java 2:*** | **Procesi i projektimit të integruar** |
| ***Java 3*:** | **Situacioni dhe peisazhi** |
| ***Java 4:*** | **Forma dhe orientimi i ndërtesës** |
| ***Java 5:*** | **Mbështjellsi i ndërtesës dhe mospërshkueshmëria nga ajri** |
| ***Java 6*:** | **Materialet e ndërtimit dhe mobiliet** |
| ***Java 7:*** | **Strategjitë e ndriçimit natyror** |
| ***Java 8:*** | **Strategjitë e ventilimit natyror** |
| ***Java 9:*** | **Strategjitë e hijezimit** |
| ***Java 10:*** | **Sistemet të ngrohjes pasive diellore** |
| ***Java 11*:** | **Sistemet pasive të ventilimit dhe ftohjes** |
| ***Java 12*:** | **Mbrojtje nga zhurma** |
| ***Java 13*:** | **Prodhimi i energjisë nga burimet e ripërtëritshme** |
| ***Java 14*:** | **Parimet standarde të shtëpisë pasive** |
| ***Java 15*:** | **Diskutimi i shembujve të ndërtesave diellore pasive** |

| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes |
|---|
| Çdo student duhet t`u përmbahet rregullave, kodit të mirësjelljes dhe politikave të UP-së.<br>**Mirësjellja:**<br>- Korrektësia në kohë dhe mirësjellje gjatë mësimit.<br>- Vijimi i rregullt i mësimit.<br>- Studenti nuk ka të drejtë të bëjë më shumë se 3 mungesa të arsyeshme ose të paarsyeshme në ligjerata ose në ushtrime.<br>- Mospërdorimi i telefonave celularë gjatë mësimit.<br>- Hyrja në sallë me kohë dhe të përgatitur me material të nevojshëm.<br>- Nxitet bashkëpunimi dhe origjinaliteti.<br>**Detyrat dhe provimet:**<br>- Dorëzimi i detyrave bëhet sipas orarit të caktuar për dorëzim. Në të kundërtën, vlerësohen me 0 pikë dhe studenti humbet të drejtën për të vazhduar më tutje syllabusin në semestrin përkatës.<br>- Plagjiatet janë rreptësisht të ndaluara. Punimet plagjiat dërgohen në komisionin disiplinor të UP-së.<br>**Të tjera:**<br>- Studentët janë të inkurajuar të kontaktojnë mësimdhënësit në rast të nevojave specifike apo të veçanta. |